



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 590/5 Prot.

Tiranë, më 25.10.2016

**V E N D I M**  
**Nr. 106, datë 25.10.2016**

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,  
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 590/1, datë 30.09.2016”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, për rastin e nëpunësit \*\*\*\*\*,

**VËREJ SE,**

Me Urdhrin nr. 590/1, datë 30.09.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë të aktit administrativ nr. 234, datë 09.09.2016, për lirim nga detyra të punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Inspektor i Policisë Pyjore”, në Degën Rajonale Elbasan, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.

Nga aktet e administruara rezulton se, punonjësi \*\*\*\*\* ka filluar marrëdhënien e punës pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, me Urdhrin nr. 1167/6, datë 21.02.2014, të Ministrit të Mjedisit, në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Policisë Pyjore, në Degën Rajonale Elbasan. Emërimi i tij është materializuar me një akt të thjesht emërimi, pa respektuar procedurat e konkurrimit, që parashikonte ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, që ishte në fuqi në atë kohë, edhe pse ky institucion ishte pjesë e shërbimit civil.

Pavarësisht këtij fakti, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe

*punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, duke qenë se ky punonjës ishte i punësuar në këtë vend pune, ka përfitur statusin e punësimit në shërbim civil, për shkak të ligjit, pasi institucioni ishte përsëri pjesë e shërbimit civil.*

Në pikën 10, të nenit 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, është përcaktuar se: “Inspektori i Policisë Pyjore është punonjësi me arsimin përkatës pyjor, me uniformë, i armatosur ....”, e për këtë arsye, Inspektorët e Policisë Pyjore, sipas ligjit, lejohen të mbajnë armë.

Ndërkohë, rezulton se, Inspektorët e Policisë Pyjore, janë punonjës të pajisur me licencë të posaçme dhe të regjistruar në listën e Inspektorëve të Policisë Pyjore, në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror, [www.inspektoratiqendror.gov.al](http://www.inspektoratiqendror.gov.al) dhe pas regjistrimit në këtë listë, në bazë të përcaktimit të mësipërm ligjor, lejohet që ata të pajisen me armë.

Nga verifikimi i kryer në këtë adresë zyrtare elektronike, rezulton se punonjësi \*\*\*\*\* , figuron në këtë listë (numri 59), e për rrjedhojë, ka licencë inspektori dhe përfshihet në detyrimin për t’u pajisur me armë.

Me ndryshimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me ligjin nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 2, të ligjit, u shtua germa “h”, në të cilën parashikohet se, nuk mund të bëjnë pjesë në shërbimin civil, punonjësit, të cilët ushtrojnë një funksion publik e që sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë.

Për këtë arsye, pozicioni i punës “Inspektor”, në Sektorin e Policisë Pyjore, në Degën Rajonale Elbasan, është përjashtuar nga fusha e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Në mbështetje të dispozitave më sipër, titullari i institucionit dhe njësia përgjegjëse (DAP), që nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, marrëdhënien e punës, për pozicionin “Inspektor i Policisë Pyjore”, e kanë trajtuar me dispozitat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Nisur nga ky fakt, me të drejtë, titullari i institucionit, me aktin nr. 234, datë 09.09.2016, ka vendosur lirimin e punonjësit \*\*\*\*\* , nga detyra “Inspektor”, në Sektorin e Policisë Pyjore, në Degën Rajonale Elbasan, sipas procedurave të parashikuara nga Kodi i Punës të Republikës së Shqipërisë.

Nisur nga gjithë sa u analizua më sipër, arrijmë në përfundimin se, bazuar në pikën 10, të nenit 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në germën “h”, të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicioni i punës “Inspektor i Policisë Pyjore”, është jashtë fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil, e për rrjedhojë, trajtimi i këtij pozicioni sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, nga titullari i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, është i drejtë.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 590/1., datë 30.09.2016, “Për verifikimin e ligjshmërisë në lidhje me statusin e pozicionit të punës “Inspektor i Policisë Pyjore”, në Degën Rajonale Elbasan”, që ka të bëjë me verifikimin e ligjshmërisë të aktit administrativ nr. 234, datë 09.09.2016, për lirim nga detyra të punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “Inspektor i Policisë Pyjore”, në Degën Rajonale Elbasan, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, si dhe kërkuesi, \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**